

Standardet Universitare Europiane të sigurimit të cilësisë në Universitetin Politeknik të Tiranës

Standardi Nr.1: Strategjia e përmirësimit të cilësisë

Universiteti duhet të ketë një politikë dhe procedura të bashkërenduara për sigurimin e cilësisë dhe të standardeve të programeve të studimit dhe të diplomave të tyre. Ai duhet të angazhohet shprehimisht për zhvillimin e një kulture e cila njih rëndësinë e cilësisë dhe të sigurimit të cilësisë në punën e tyre. Për të arritur këtë universiteti duhet të zhvillojë dhe të vërë në jetë një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat duhet të kenë një status zyrtar dhe të jenë të disponueshme publikisht. Ato gjithashtu duhet të përfshijnë një rol për studentët dhe palët e tjera të interesuara.

Standardi Nr.2: Monitorimi i programeve dhe diplomave

Universiteti duhet të ketë mekanizmin zyrtar për aprovimin, rivlerësimin periodik dhe monitorimin e programeve dhe diplomave të tyre.

Standardi Nr.3: Kriteret e vlerësimit të studentëve

Studentet duhet të vlerësohen duke përdorur kritere të publikuara, rregulla dhe procedura të cilat aplikohen në mënyrë të qëndrueshme.

Standardi Nr.4: **Kualifikimi i stafit akademik**

Universiteti duhet të ketë mënyra për t'u siguruar se stafi i përfshirë në mësimdhënien e studenteve është i kualifikuar dhe kompetent. Ai duhet të jetë i disponueshëm ndaj atyre që ndërmarrin vlerësimet e jashtme dhe ndaj komenteve të raporteve.

Standardi Nr.5: **Burimet e disponueshme për mësimnxënien**

Universiteti duhet të sigurohet që burimet e disponueshme për të mbështetur mësimnxënien e studentit, janë të përshtatshëm dhe të përshtatur për çdo program të ofruar.

Standardi Nr.6: **Informacion i përshtatshëm**

Universiteti duhet të sigurohet se ato mbledhin, analizojnë dhe të përdorin informacion të përshtatshëm për administrimin efektiv të programeve të tyre të studimit dhe të aktiviteteve të tjera.

Standardi Nr.7: **Informacion i paanshëm**

Universiteti duhet të publikojë rregullisht informacion të azhornuar, objektiv dhe të paanshëm si sasior dhe cilësor për programet e studimit dhe diplomat që ai ofron.

